



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. Prot.
2495

Tiranë, më 24.09 2024

NJOFTIM
PËR APLIKIM PËR EKSPERT TË JASHTËM INXHINIER ELEKTRIK
INXHINIER MEKANIK

(angazhim me kontratë shërbimi)

Universiteti i Sporteve të Tiranës, në zbatim të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në kuadër të tenderimit me object: “Ngritja e sistemit të ventilimit dhe kondicionimit librit fizik dhe sallës së leximit” të Autoritetit Kontraktor, Universiteti i Sporteve të Tiranës, për të qenë pjesë e Grupeve të Punës, 1 (një) Inxhinjer i fushës së Inxhinjerisë Elektrike dhe 1 (një) Inxhinjer i fushës së Inxhinjerisë mekanike si ekspert i jashtëm (të angazhuar me kontratë shërbimi).

Eksperti i Inxhinjerisë Elektrike duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare sipas fushës së kërkuar, (Inxhinier elektrike).
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vite.
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë brenda datës 30.09.2024, në zyrën e Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit);
- Kopje e noterizuar e licencës në fushën e Inxhinjerisë Elektrike;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
- Vetëdeklarim mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

Eksperti i Inxhinjerisë mekanike duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare sipas fushës së kërkuar, (Inxhinier mekanike).
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vite.
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë brenda datës 30.09.2024, në zyrën e Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit);
- Kopje e noterizuar e licencës në fushën e Inxhinierisë mekanik;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
- Vetëdeklarim mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

Mënyra e vlerësimit: Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje.

ADMINISTRATORI

Haxhirete Sulaj

